



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile

RAPORT MONITORIMI FINANCIAR
PER VITIN 2014

Agjencisë për Mbështetjen e Shoqerise Civile, në mbështetje të ligjit nr. Nr. 1185/2013, “Per buxhetin e shtetit për vitin 2014”, Udhezimit te Ministrit te Financave nr. 2 datë 06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimin te buxhetit”

dhe Udhezimit nr.3 datë 17.01.2014 “Per zbatimin e buxhetin e shtetit për vitin 2014”, i është akorduar një fond i planifikuar prej **120 milione e 500 mijë lekë**, i detajuar si më poshtë (Tab.Nr.1) nga:

Tabela Nr.1

Fondi i Pagave:	11,500,000 Lekë (zeri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqerore:	2,000,000 leke (zeri 601)
Fondi per Shpenzime Operative:	6,000,000 Lekë (zeri 602)
Fondi per transfertat ndaj te treteve:	100,000,000 Lekë (zeri 604)
Fondi per Investimet e Trupezuara:	1,000,000 Lekë (zeri 231)
TOTAL	120,500,000 LEKE

Përgjatë vitit financiar 2014, ndryshimet e ndodhura në **Planin Vjetor 2014** sipas artikujve si më poshtë vijon (Tab Nr.2) :

1- **Pakësim** në “Zërin Fondi për Shpenzime Operative” (602) me 1,500,000 Leke

2- **Pakësim** në “Zërin Fondi për transfertat ndaj të tretëve” (604) me 2,000,000 Leke

3- **Shtim** në “Zërin Fondi për Investimet e Trupëzuara” (231) me 1,300,000 Leke

4- **Pakësim** në “Zerin Fondi për Investimet e Trupëzuara” 231 me 253, 880 Leke.

Tabela Nr.2

Ecuria e realizimit te Shpenzimeve Buxhetore Janar - Dhjetor 2014				
Artikulli Shpenzimeve/Muajt		Shpenzimet Progressive Fakt	Plani Vjetor sipas ndryshimeve te bera gjate vitit	Realizimi ne Perqindje
600		10,217,214	11,500,000	88.85%
601		1,639,238	2,000,000	81.96%
602		4,398,129	4,500,000	97.74%
604/1		97,756,588	98,000,000	99.75%
231		2,046,120	2, 046, 120	100 %
604/6		6,300,000	7,000,000	90.00%
Totali		122,357,289	125,300,000	97.65%

- Me shkresë Nr.12555/2, dt.12.09.2014 me Subjekt “ Mbi detajimin e Aktit Normativ të buxhetit të shtetit të vitit 2014”, AMSHC u vu në dijeni të pakësimeve prej nje totali 3,500,000 lekësh të cilat u pa e arsyeshme të bëheshin dhe të kalonin për llogari të buxhetit të shtetit për institucione me nevoja më emergjente për likuiditete.
- Ndërkohë me kërkesë zyrtare nga AMSHC u miratua fondi ekstra prej 1,300,000 lekësh për zerin e investimeve me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.778, dt.19.11.2014 “ Për një shtese fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) “ si dhe përcjellë ndaj AMSHC së nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtise dhe Sipermarjjes me shkresë zyrtare Nr.prot.8183/1, dt.1.12.2014 me subjekt “ Mbi zbatimin e VKM se nr.778 datë 19.11.2014”.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore (zeri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar, me VKM Nr. 769, date 15.07.2009 dhe të VKM Nr. 55 Date 26.01.2011 “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2011, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”.

Gjatë vitit 2014, numri mesatar i punonjësve për AMSHC në është realizuar 13 punonjes.

Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe shperblimeve, si dhe i sigurimeve shoqerore, gjatë këtij viti, është realizuar respektivisht;

- **10,217,214 Lekë** (zeri 600) për paga, realizimi **88.85 %**.
- **1,639,238 Lekë** (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore, realizimi **81.96 %**.

Fondi për shpenzime në zerin Mallra dhe Shërbime (zeri 602), për vitin 2014, është planifikuar në vlerën 6,000,000 leke dhe me ndryshimet e mëvonshme sqaruar më lart arriti në vlerën 4,500,000 leke . Edhe për këtë zë, për gjatë vitit 2014 është realizuar vlera prej **4,398,129 Lekë** ose **97.74 %** e planit vjetor.

Gjithashtu, në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC është mbështetur në një shpërndarje sa më racionale të kërkesave si dhe në “Rregjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike” të cilat kryesisht lidhen me;

- Realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, uje, shërbime postare e telefonike, në funksion të një veprimtarie normale institucionale.
- Kyerjen e të gjitha blerjeve për nevojat e AMSHC, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, etj.
- Kryerjen e pagesave për likuidimin e detyrimeve furnitore dhe të treta, të mbartura nga 2013.

Fondi në zërin për Transferime Korrente të Brendshme (zëri 604), për vitin 2014 është planifikuar në vlerën 100,000,000 leke. Ky është dhe zëri më i rëndësishëm në strukturën e buxhetit të AMSHCsë, duke qenë se dhe vetë Misioni i këtij institucioni ka si qëllim kryesor financimin e Shoqërisë Civile me Grante për projektpropozimet e OJF përfituese. Edhe për këtë zë, ka pasë ndryshime nga Plani fillestar si shpejguar më lart dhe aktualisht **604 Kapitulli 1** sipas Planit Vjetor është 98,000,000 leke dhe për periudhën respektive është realizuar vlera prej **97,756,588 Lekë** ose **99.75 %** e planit vjetor.

Ndërkohë disbursimet e zërit të Granteve kanë përfshirë disbursime nga Thirrja Nr.3, Thirrja Nr.4 dhe në gjysmën e dytë të Vitit fiskal 2014 janë disbursuar Projektet fituese të Thirrjes 5 dhe Thirrjes 6.

Një nga Riset në disbursimet e Thirrjeve të fundit të shpallura nga AMSHC në gjysmën e dytë të vitit, është dhe mënyra e Financimit (70% Pjesa e parë e disbursimit dhe 30% Pjesa Finale e Raportim/Disbursimit) e tillë që i përshtatet si projekteve fituese ashtu edhe afateve kohore në të cilat Thirrjet u bënë publike.


Në zërin e Transfertave të brëndshme, është edhe shuma prej 7,000,000 lekesh e akorduar me Urdhër të posacëm të Ministrit të Financave Nr.30, dt.17.06.2013 “ Për Financimin e Projekteve dhe mënyrat e përdorimit të fondit të posacëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimit ligjor”

Për këtë, pra 604 Kapitulli 6, gjatë vitit financiar 2014, është disbursuar shuma prej 6,300,000 lekesh me një realizim në përqindje prej 90 %.

Në tabelën Nr.3 më poshtë, evidentohet ecuria e disbursimeve të granteve financiare (Llogaria 604 - Kapitulli 1) sipas muajve gjatë vitit 2014, si dhe në grafikun më poshtë qartësohet kjo ecuri disbursimi në formë grafiku ku duket qartë edhe puna e madhe që është përqendruar në gjysmën e dytë të vitit 2014, duke korresponduar kjo periudhë me shpalljen e dy Thirrjeve për Mbështetje me Grante ndaj Shoqërisë Civile.

Tabela Nr.3 (ne Leke)

	Viti 2014	Fondet e Disbursuara
1	Janar	1,488,000
2	Shkurt	1,939,000
3	Mars	2,841,000
4	Prill	4,222,000
5	Maj	0
6	Qershor	708,000
7	Korrik	653,000
8	Gusht	36,960,000
9	Shtator	2,577,000
10	Tetor	28,718,588
11	Nentor	6,370,000
12	Dhjetor	11,280,000
	TOTALI	97,756,588



Fondi per shpenzim investime (zeri 231) ,

Pas ndryshimeve ne Planin fillestar vjetor si shpjeguar më lart, Fondi për Investime të trupëzuara arriti ne 2,300,000 Lekë (zeri 231) për Investime te Trupezuara, fond i cili është vënë në përdorim në vlerën 2,046,120 leke me realizim në përqindje prej 88.96 %.

Ky fond eshte përdorur kyesisht për ristrukturimin e ambienteve të reja në të cilat do të vendoset AMSHC në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.666 datë 8/10/2014 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) te Këshilli i Ministrave, për Agjencinë e Mbështetjes së Shoqërisë Civile, të godinës së Observatorit të Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit e Mjedisit”.

Në datën 29 Dhjetor 2014, u bë një rishikim tjetër i fundit për Buxhetin e Vitit 2014 duke reduktuar fondin e Investimeve me 253,880 leke.

AMSHC, ka zbatuar me korrektesi te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga Ligji Nr. 10093 Date 09.03.2009 ”Per Organizimin dhe Funksionimin e Agjencise per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile”, si dhe legjislacionin admnistrativo-financiar shqiptar.

Drejtor Ekzekutiv

Andi KANANAJ